



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prombena Me Datë 29.11.2024			
Nr. Llogarit Org. Breg	Numri Breg	Shifra e Pronës	Vlera Vrednost
01-110/05-65			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dhe neni 6, paragrafi 1, pika 1.2, neni 8, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës, sipas kërkesës nga ana e Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal me shkresë Nr.020-315/5, të datës 23.12.2024, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.01.2025 miraton këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me Nr. 01-035/02-1358, të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës miraton vendim për ndryshimin dhe plotësimin i vendimit paraprak me Nr.01-035/02-1358, të datës 29.11.2024 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes shprehjes së ineteresit, sipas kërkesës nga ana e Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal me shkresë Nr.020-315/5, të datës 23.12.2024.

Neni 2

Ndryshohet preambula e Vendimit me Nr.01-035/02-1358, të datës 29.11.2024, tek neni 6, paragrafi 1, pika 1.1, neni 8, paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës, ndryshohet plotësohet dhe duhet të jet neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Neni 3 i Vendimit me Nr.01-035/02-1358, të datës 29.11.2024 ndryshohet plotësohet dhe duhet të jet prona e paluajtshme komunale jepet në shfrytëzim afatgjatë deri në 20 vite përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 4

Pjesët tjera të Vendimit me Nr.01-035/02-1358, të datës 29.11.2024 mbeten të pandryshuara.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10 pika 6, të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen të Komunës së Vitisë

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Kadastër, Pronë;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar / Prilbjen / Më Datën 29-11-2024			
Nr. Llogarit Org. Breg	Nr. Breg	Shifra Prilbjet	Vlera Vrednost
01-	035	02-	1358



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8, paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14 të Ligjit me Nr.06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës, neni 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.11.2024 miraton këtë:

VENDIM

Paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës miraton vendim që të **jepet pëlqimi** për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatgjatë përsonave fizik dhe juridik deri në 20 vite, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, respektivisht vendosjen e paneleve solare përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2

Prona e palujtshme për dhënien në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zhabelj, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 96342 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zabel, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 130577 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Çmimi fillestar i pronave të palujtshme komunale të cekura në nenin 2 pika 1 dhe 2 të këtij vendimi do ta përcaktoj komisioni vlerësues i ofertave për dhënien e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim afati gjatë.

Neni 4

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është interesi publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 5

Procedurat për dhënien e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes shprehjes së interesit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Zyra për Administratë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Financa e Komunës së Vitisë.

Neni 7

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Kadastër, Pronë;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA



Pranuar - Prilapuar / Received - Received 13-11-2024

Nr. i Propozimit Op. Nr.	Titulli i Propozimit	Shprehja e Vlerësimit	Vlera e Vlerësimit
02	033	02	1286

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/1-40, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5 paragrafi 1 pika 1.3 neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 13.11.2024, bën këtë :

PROPOZIM VENDIM

Paraparak për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraparak, propozohet të jepet pëlqimi për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim afatgjatë përsonave fizik dhe juridik deri në 20 vite, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, respektivisht vendosjen e paneleve solare përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2.

Prona e palujtshme për dhënjën në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij propozim –vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zhabelj, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 96342 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00200-0, në zonën kadastrale në Devajë, në vendin e quajtur Zabel, me kulturë Kullosë e klasit të 6, me sipërfaqe prej 130577 m², e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Çmimi fillestar i pronave të palujtshme komunale të cekura në nenin 2, pika 1 dhe 2 të këtij propozim-vendimi do ta përcaktoj komisioni vlerësues i ofertave për dhënjën e pronës së palujtshme të Komunës në shfrytëzim afati gjatë.

Neni 4.

Qëllimi i dhënjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 5.

Procedurat për dhënjën e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes shprehjes së inereit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Palujtshme të Komunës.

Neni 7.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Zyra Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 8.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
Sokol Haliti






AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN


Zyra Kadastrale Komunalne/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Devajë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-70101018-00197-0	Parcelë / Parcela / Parcel	96342
P-70101018-00200-0	Parcelë / Parcela / Parcel	130577



Shkalla/Razmera/Scale: 1:7535



Punoi/Obradio/Created: Kushtrim Imeri

Nënshtkrimi/Potpis/Signature:

Data/ Data/Date: 13.11.2024

Koha/ Vreme/ Time: 10:24:09



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostornoeg Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Vitisë

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1595/2024
Data dhe koha e kështimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:	13.11.2024 - 09:16
Komuna / Opština / Municipality:	VITI / VITINA / VITI
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office:	VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri i me First Name	Emri i babait ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Liceni broj/broj postovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Drzava državljanstva ili okružjenja Country citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rođenost/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijanje me datim Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Komuna e Vitisë			/	600424486	KOSOVA/ KOSOVA/ KOSOVO		29.12.2020	

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postai Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Populnost adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
/		28 NENTORI		



B. NĒSĪA KADASTRALE/ KATASTRĀLSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Identifikācijas numurs / Identification number	Municipality	Kadastriālā zonu / Cadastral zone	Teritorijas veids / Land use type	Tipa ieraksts / Tip in the property type	Karte / Map	Vienības nosaukums / Unit name	Superficial area / Paved area	Shēmas izstrādes / Kultūra - klasifikācija / Act / Culture-class	Procentuālais īpašums / Share in the property	Tipa ieraksts / Tip in the property	Azbuķu atjaunināšana / Updated
00143-0	VITINA / VITI	Devja / Devja	PARCELE / PARCELA / parcel	Prasīgojuma / Prasīgojuma / Land /	1:10000	ZHABEL / ZHABEL	96342	Būvniecība - Kultūra - E Klase 6 / / Poljoprivredno - Pašņaci - Pasņak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / /	1 / 1	Posēdums / Individual / Individual / Džavina / Single possessor	
P-70101018-00200-0	VITINA / VITI	Devja / Devja	PARCELE / PARCELA / parcel	Prasīgojuma / Prasīgojuma / Land /	1:10000	ZHABEL / ZHABEL	130577	Būvniecība - Kultūra - E Klase 6 / / Poljoprivredno - Pašņaci - Pasņak 6 Klase / / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / /	1 / 1	Posēdums / Individual / Individual / Džavina / Single possessor	